**VENDIM**
**Nr. 58, datë 23.4.2015**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "GAEA - ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBËR" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 3, pika 31; 8, pika 2, germa "a"; 9 dhe nenit 45, pika 4, dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "f"; 5, pika 1, germa "f"; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "GAEA - Energjia Alternative e Gjelbër" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe të Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "GAEA - Energjia Alternative e Gjelbër" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuar nga ERE, në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- dokumentacioni i përgjithshëm, dokumen-tacioni juridik, administrativ dhe pronësor, dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pikat 1, 2, 3) është i plotësuar tërësisht;
- të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/9, germat "a", "b" dhe "c") janë plotësuar tërësisht;
- të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/9, germat "a", "b" dhe "c") janë plotësuar tërësisht;

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "GAEA - Energjia Alternative e Gjelbër" sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**